




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Nr. 62/202

Datë: 12.07.2024

Bazuar në nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 dhe 1.5, nen 29, paragrafi 1, me nën paragrin 1.1, 1.2, nen 35 paragrafi 1, nen 37 nen 39, nen 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës (*Gazeta zyrtare Nr.14/7 e dt. 07.06.2022*), Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2023 për Përcaktimin e Tregut Relevant si dhe Rregulloren Nr. 01/2023 për Procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën 12.07.2024 nxjerr:

K O N K L U Z I O N
për fillimin e procedurës hetimore ndaj:

- I. Artmotion Sh.p.k., me numrin unik identifikues: 810200866, adresa: Rr. "Lidhja e Pejës", p.n. (ish-Fabrika e Amortizatorëve) kodi postar: 10000, Prishtinë, për shkak të dyshimit se e njëjta ka kushtëzuar lidhjen e marrëveshjes apo kontratës për shpërndarje të kontentit për disa kanale televizive duke zbatuar kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ndërmarrjet tjera në pozitë të pafavorshme konkurruese, duke ndarë tregun në baza gjeografike/territoriale, duke kufizuar konkurrencën dhe zhvillimin e lirë dhe penguar qasjen e lirë në treg.
- II. Autoriteti i Konkurrencës kërkon nga ndërmarrja e lartcekur, si në dispozitivin I të këtij konkluzioni që në afat prej **30 ditësh** t'i sjellin në zyrat e Autoritetit këto dokumente:
 - a) Statutin e ndërmarrjes dhe dokumentet përcjellëse në ARBK;
 - b) Raporti i auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2023 nga një kompani e auditimit e licencuar në Kosovë.
 - c) Kontratat për kontent ose Marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të Artmotion Shpk dhe ISP Broadcast dhe operatorëve tjerë.

Autoriteti i Konkurrencës
Rr. "Migjeni" nr. 21, ish objekti i "Bankës së Lubjanës" katër i VI-të, Prishtinë
+381 /0/ 38 200 10982 info.konkurrenca@rks-gov.net

- III.** Në rast se palët në procedurë nuk i dorëzojnë komentet dhe dokumentet e kërkuar si në dispozitivin **II** të këtij konkluzioni apo dorëzojnë dokumente të pa-sakta apo të rreme, Autoriteti do të konstatojë shkeljen e këtij ligji dhe do t'u shqiptojë palëve sanksionin administrativ deri në 1% të qarkullimit të përgjithshëm që ka realizuar në tërë botën në vitin e fundit për të cilin është përmbyllur raporti financiar dhe pastaj do të vazhdojë procedurën hetimore duke i përdorur instrumentet tjera ligjore të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- IV.** Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

A R S Y E T I M

Autoriteti i Konkurrencës me datë 29.01.2024 në shkresën me nr. prot. 50/24-08/H, ka pranuar ankesë nga ISP-Broadcast kundër Artmotion Sh.p.k, me numrin unik identifikues: 810200866. Pretendimet e ankuesit janë se e njëjta ka kushtëzuar lidhjen e kontratës apo marrëveshjes për kontent me ISP Broadcast lidhur me transmetimin e kanaleve televizive Klan Kosova, T7 dhe Kanal 10. Për arsy se këto kanale në bashkëpunim me operatorin tjetër të shpërndarjes Artmotion, refuzojnë që të lejojnë transmetimin e kanaleve gjegjëse në platformën tyre, praktikë kjo që është në kundërshtim me detyrimin e ofruesve të shërbimeve mediale për të promovuar politikat e transmetimit duke promovuar konkurrencën e drejtë. Këto kanale televizive, shprehimisht janë deklaruar që të drejtat ekskluzive të transmetimit i ka operatori i shpërndarjes Artmotion.

Sipas Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës lidhur me këtë rast Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka filluar monitorimin e tregut përkatës në zbatim të nenit 35 dhe 39 për fillimin e procedurës hetimore ndaj ndërmarrjes "Artmotion" Sh.p.k., e cila vepron në tregun përkatës me aktivitete të ndryshme dhe ndër të tjera me ofrimin e shërbimeve të internetit, kabllorë dhe kanaleve televizive, për shkak të dyshimit të bazuar se në raportet kontraktuale përmes arritjes së marrëveshiave të bashkëpunimit me ISP Broadcast për ofrimin e shërbimeve të Artmotion për kanale televizive të platformës Artmotion, me të cilën ka kushtëzuar operatorin ISP Broadcast duke keqpërdorur pozitën e saj në platformën si ofrues i shërbimeve të telekomunikacionit, duke kufizuar konkurrencën, ndarjen e tregjeve, penguar qasjen në treg, kushtëzimin e lidhjes së kontratave në treg ndaj ndërmarrjeve tjera, kontrata të paligjshme me elemente diskriminuese dhe me të drejta të veçanta, diferencim në çmime ndaj operatorëve të ndryshëm dhe sjellje antikonkurruese, sepse në rast se nuk i pranojnë kushtet e këtyre kontratave për pasojë të operatorit ISP Broadcast ia ka larguar kanalet nga platforma e saj.

Televizonet Klan Kosova, T7 dhe Kanal 10, përmes ofertave të tyre kanë vendosur kushte ose çmime të pafavorshme komerciale në raport me operatorin e shpërndarjes, me ISP Broadcast, duke mos marrë në konsideratë detyrimet e operatorëve të shërbimeve mediale e audiovizuale për promovimin e konkurrencës dhe dhënies së sinjalit në baza jo diskriminuese.

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas fillimit të monitorimit, respektivisht shqyrtimit paraprak të hetimit ka bërë mbledhjen e të dhënave, lidhur me identifikimin e tregjeve, atë të komunikimeve elektronike-internet dhe shpërndarjes audiovizive - kabllore, krahas kësaj kemi gjetur se të njëjtat janë tregje të rregulluara bazuar në ligjet dhe institucionet përkatëse për licencimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve/ndërmarrjeve në tregun përkatës.

Palët në procedurë të zhvilluar nga Autoriteti i Konkurrencës konsiderohen ndërmarrjet:

Palët në procedurë të zhvilluar nga Autoriteti i Konkurrencës konsiderohet ndërmarrja e cekur në pikën I të dispozitivit të këtij Konkluzioni.

Tregu i telekomunikimeve, respektivisht kabllovik janë tregje të rregulluara në Republikën e Kosovës, përkatësisht për tregun e telekomunikimeve është përgjegjës Autoriteti Rregulator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP, i cili mbikëqyrë ndërmarrjet të cilat ofrojnë shërbimet e internetit, telefoni mobile dhe fiksë dhe Komisioni i Pavarur për Media – KPM, i cili është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës dhe është përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të shpërndarjes, respektivisht ofruesve të shërbimeve mediale, audio dhe audiovizule të cilët operojnë në Republikën e Kosovës, ndërsa Autoriteti i Konkurrencës ndërmerr masa me qëllim të parandalimit, kufizimit dhe shtrembërimit të Konkurrencës

Bazuar në këtë, Autoriteti i Konkurrencës për të adresuar dyshimet lidhur me kufizimin e konkurrencës, përmes kontratave të dëmshme që zakonisht janë të kushtëzuara dhe në kundërshtim me nenin 5, parografi 1, nën-paragrafët, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nxori këtë konkluzion për fillimin e procedurës hetimore.

Andaj, në bazë të kushteve të lidhjes së marrëveshjes në mes të palëve, ka prova dhe fakte të pengimit dhe kufizimit të konkurrencës në tregun përkatës, duke kushtëzuar lidhjen e kontratës me detyrimet shtesë, politika të ndryshme si dhe draft kontratë paraprake të pa nënshkruar nga operatori ISP Broadcast me qëllim kushtëzimin e shitblerjes së aseteve të infrastrukturës, respektivisht shitjen e ISP Broadcast tek Artmotion sh.p.k.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 37 dhe nenit 55 parografi 2 nën parografi 2.1të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

Autoriteti i Konkurrencës

Rr. "Migjeni" nr. 21, ish objekti i "Bankës së Lubjanës" katër i VI-të, Prishtinë
+381 /0/ 38 200 10982 info.konkurrenca@rks-gov.net

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni për fillimin e procedurës hetimore nuk është e lejuar ankesa dhe as padia për inicimin e konfliktit administrativ.

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Komisioni

Neime Binaku - Isufi

Kryetare

Kaltrina Sela

Nënkyetare

Florent Mehmeti

Anëtar

Nafije Osdautaj

Anëtar

Salihe Gashi Loku

Anëtar

Me këtë KONKLUZION njoftohen:

- *Armotion Sh.p.k;*
- *ISP Broadcast Sh.p.k.;*
- *Arkiva.*

Autoriteti i Konkurrencës

Rr. "Migjeni" nr. 21, ish objekti i "Bankës së Lubjanës" kati i VI-të, Prishtinë
+381 /0/ 38 200 10982 info.konkurrenca@rks-gov.net